



**Qendra për Këshillim në Karrierë  
Komuna e Prishtinës**

**Komuna e Prishtinës, në kuadër të Projektit “Themelimi i Qendrës së Karrierës dhe Qendrës së Biznesit” të financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar shpall:**

**KONKURS**

Për angazhimin e një programeri për zhvillimin e programit CSM (Career Service Manager) për nevojat e **Qendrës për Këshillim në Karrierë**.

**Modulet kryesore:**

1. Sistemi i Administrimit CSM duhet të përmbaj të gjitha modulet e nevojshme për menaxhimin e përgjithshëm të të gjithë solucionit.
2. Sistemi i Administrimit të Profileve të Studentëve duhet të përmbaj modulet përkatëse për menaxhimin e profilit të studentëve.
3. Sistemi i Administrimit të Profileve të Bizneseve duhet të përmbaj modulet përkatëse për menaxhimin e profilit të bizneseve.
4. Programi duhet të zhvillohet në PHP dhe MySQL duke mos përdorur ndonjë frameëork.

**Kriteret**

- Programeri duhet të ketë eksperiencë paraprake në zhvillim të CMS ose solucione tjera për menaxhim
- Duhet të ketë më shumë së tre (3) vite eksperiencë në fushën përkatëse
- Duhet të sjellë dy (2) referenca nga punët e ngjashme paraprake.

Pjesëmarrja në këtë konkurs është e hapur për të gjithë personat fizik dhe juridik, të cilët kanë përvojë pune në trajnimin e stafit të Qendrave të karrierës.

Pyetjet dhe informatat e tjera të cilat kanë të bëjnë me konkursin mund të dërgohen në email adresën [merita.mustafa@rks-gov.net](mailto:merita.mustafa@rks-gov.net) deri me datën 26.02.2016, ora 16:00.

Aplikimi duhet të dërgohet më së largu me 29.02.2016, ora 16:00, në email adresën [merita.mustafa@rks-gov.net](mailto:merita.mustafa@rks-gov.net)

Pas skadimit të afatit të konkursit, ofertat nuk do të merren parasysh.

**Adresa:**

Komuna e Prishtinës

Rr. UÇK Nr. 2, Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 230 900

**Qendra për Këshillim në Karrierë, Komuna e Prishtinës**

Qendrën për Këshillim në Karrierë funksionon në kuadër të Komunës së Prishtinës dhe krijon parakushtet për lidhjen e shkollave Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP) me sektorin privat, dhe që do të kontribuon tek studentët e shkollave AAP në ndërtimin e efektshmërisë ndërpersonale, rritjen e mundësive për karrierë, përmirësimin e tregtueshmërisë së punësimit, promovimin e gjetjes efektive të vendit të punës dhe përforcimin e marrëdhënjeve me punëdhënësin.

**Roli i Qendrës për Këshillim në Karrierë**

Qendra për Këshillim në Karrierë e Komunës së Prishtinës do të luaj një rol vendimtar në përforcimin e lidhjeve në mes të sektorit privat dhe shkollave Arsimit dhe Aftësimi Profesional. Qendra do t'u ofrojë nxënësve të shkollave AAP mundësitë për të fituar njohuri, aftësi, përvojën e duhur për të identifikuar opcionet; për të shqyrtuar alternativat në tregun e punës dhe për të patur sukses në shoqëri.